

## MARRRËVESHJE

### NDËRMJET

MINISTRISË SË MBROJTJES SË REBUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### PËR BASHKPUNIMIN NË FUSHËN E KËRKIM SHPËTIMIT MALOR DHE UJRAVE TERRITORIALE

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës (në vijim referuar si Palët);

Të gatshëm për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve në bazë të barazisë, përfitimit të përbashkët dhe respektimit të së Drejtës Ndërkombëtare, njohin përfitimet e arritura nga bashkëpunimi i ngushtë i deritanishëm në lidhje me operacionet e kërkim-shpëtimit malor dhe ujërave territoriale dhe trajnimit të SAR;

Duke marrë parasysh domosdoshmërinë e përmirësimit të mëtejshëm të sigurisë në fushën e Kërkim Shpëtimit, bazuar në respektin reciprok të sovranitetit kombëtar përkatës;

Kanë rënë dakord për sa më poshtë:

#### Neni 1 Termet dhe përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- 1.1 "Pala kërkuese" do të jetë Pala bashkëpunuese në këtë Marrëveshje ose institucioni i autorizuar prej saj, që kërkon ndihmë nga Pala tjetër bashkëpunuese bazuar në këtë Marrëveshje.
- 1.2 "Pala ndihmuese" do të jetë Pala bashkëpunuese në këtë Marrëveshje, që do t'i përgjigjet Palës Kërkuese për ndihmë.
- 1.3 "Autoritet kompetent" nënkupton organin përkatës të çdo Pale për të menaxhuar dhe për të bashkërenduar aktivitetet në bazë kësaj Marrëveshjeje.
- 1.4 "Kërkim": Një operacion, i koordinuar normalisht nga një qendër koordinimi shpëtimi ose nënqendër shpëtimi, duke përdorur personelin dhe pajisjet në dispozicion për të gjetur personat në vështirësi.
- 1.5 "Shpëtim": Një operacion për të tërhequr personat në vështirësi, për të siguruar nevojat e tyre fillestare mjekësore ose të tjera dhe për t'i dërguar ata në një vend të sigurt.

- 1.6 Qendra e Koordinimit të Shpëtimit (RCC): Një njësi përgjegjëse për promovimin e organizimit efikas të shërbimeve të kërkimit dhe shpëtimit dhe për koordinimin e kryerjes së operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit brenda një rajoni kërkimi dhe shpëtimi.
- 1.7 Për Republikën e Shqipërisë: Qendra Kombëtare e Kërkimit dhe Shpëtimit.
- 1.8 Për Republikën e Kosovës: Forca e Sigurisë së Kosovës.
- 1.9 “Ndhimja - dhënia e ndihmës” nënkupton ndihmën e ofruar nga ekipet e shpëtimit, ekspertët, pajisjet apo ndihma humanitare dhe çdo veprim tjetër me qëllim eliminimin e pasojave të menjëhershme apo anësore që vijnë nga fatkeqësia.
- 1.10 “Ekipet e shpëtimit dhe ekspertë që marrin pjesë në dhënien e ndihmës” është personeli i trajnuar apo grupe ekspertësh të specializuar dhe të pajisur për të ndërhyrë në fusha të caktuara, ofruar nga Pala ndihmuese.
- 1.11 “Pajisje” do të thotë materiale, mjete teknike dhe transporti, barna dhe pajisje mjekësore dhe pajisje individuale të anëtarëve të njërive/ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertëve.
- 1.12 “Incident kërkim-shpëtimi”, Çdo situatë që kërkon informimin dhe njoftimin e sistemit SAR dhe që mund të kërkojë operacionet SAR.
- 1.13 Vendngjarje: Zonë kërkimi ose vendi aktual i rrezikut/aksidentit.

## Neni 2

### Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që Palët, brenda mundësive të tyre, të ndihmojnë njëra-tjetrën në rritjen e kapaciteteve, si dhe në reagimin në raste të fatkeqësive/Incidente ajrore (me vendngjarje në tokë apo në ujërat e territoriale), kur Pala kërkuese, me kapacitetet që ka, nuk mund të menaxhojë plotësisht pasojat e fatkeqësisë.
2. Palët në këtë Marrëveshje, brenda kuadrit ligjor të tyre, do të jenë të gatshme për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar në fushën e kërkim shpëtimit, lidhur me:
  - 2.1 planifikimin dhe masat parandaluese për t'u mbrojtur nga fatkeqësi/ Incidente ajrore, (me vendngjarje në tokë apo në ujërat e territoriale), që mund të ndodhin në territorin e njëres nga Palët;
  - 2.2 ndihmë të ndërsjellë në rast operacioni SAR;
  - 2.3 trajnimin dhe ushtrimin e strukturave operacionale të Palëve, të cilat angazhohen për kërkim-shpëtim.
3. Marrëveshja do të hapë rrugë krijimit të një Qendre të Përbashkët në fushën e kërkim shpëtimit në Shqipëri dhe kornizës ligjore përkatëse.
4. Njësitë/ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertët do të ndërpresin aktivitetet e tyre menjëherë pas kërkesës së autoritetit përgjegjës të Palës kërkuese ose kur qëllimi i ndihmës ka përfunduar.

## Neni 3

### Objektivat dhe fushat e veprimit

1. Kjo marrëveshje përcakton një kornizë për bashkëpunimin midis Palëve në kryerjen e operacione të kërkim shpëtimit malor dhe ujërat territoriale të vendeve.

2. Palët duhet të sigurojnë koordinim të ngushtë me autoritetet e tyre përkatëse për të ndihmuar në promovimin e shërbimeve të përbashkëta të kërkim shpëtimit sipas kësaj marrëveshjeje.

#### **Neni 4**

##### **Autoritet kompetentet dhe pikat e kontaktit**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, Palët do të bashkëpunojnë drejtpërdrejtë brenda kompetencave të veta, në bazë të legjislacionit të tyre kombëtar dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar nga Palët.
2. Autoritetet kompetente në bazë të kësaj Marrëveshjeje janë:
  - 2.1 Për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit (Autoriteti).
  - 2.2 Për Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës (Autoriteti).
3. Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve, siç përcaktohet në paragrafin e këtij neni, do të autorizohen për të hyrë menjëherë në kontakt të drejtpërdrejtë.
4. Palët do të informojnë njëra-tjetrën në rast të ndodhjes së fatkeqësisë SAR.
5. Palët e kësaj Marrëveshjeje do të caktojnë një ose disa pika kontakti, me qëllim të njoftimit dhe shkëmbimit të informacionit në rast fatkeqësie. Autoritetet kompetente do të garantojnë funksionimin e pandërprerë të pikave të kontaktit.
6. Palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën me shkrim për çdo ndryshim në organet kompetente dhe pikat e kontaktit.

#### **Neni 5**

##### **Përgjegjësitë**

1. Secila Palë, me marrjen e informacionit për një incident SAR (referuar në nenin 3) kur ndonjë person/persona është/janë në gjendje të vështirë brenda rajonit të saj të përgjegjësisë, duhet të marrë masa urgjente për të siguruar ndihmën më të përshtatshme pavarësisht nga kombësia ose statusi i një personi të tillë, ose rrethanat në të cilat ka ndodhur kjo fatkeqësi ose zbulohet një e tillë.
2. Secila Palë, të mbajë dhe të zhvillojë kapacitete dhe facilitete të ndërveprueshme për operacione SAR.
3. Për të siguruar që operacionet e SAR të kryhen në një mënyrë efikase dhe të koordinuar, Palët duhet të konsultohen dhe bashkëpunojnë me njëra-tjetrën kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, duke dhënë ndihmë të ndërsjellë siç lejojnë aftësitë e tyre.
4. Secila Palë mund të kryejë operacione SAR brenda rajonit të SAR të Palës tjetër nën koordinimin e autoriteteve kompetente së Palës tjetër.
5. Autoritetet e përcaktuara në këtë marrëveshje do të sigurojnë të gjitha detajet përkatëse në fushën e ndihmës ose lehtësive të kërkuara.
6. I gjithë informacioni i mbledhur si rezultat i aktiviteteve të kryera, në përputhje me këtë Marrëveshje, mund t'u jepet palëve të treta dhe publikut, vetëm në bazë të miratimit të dhënë

më parë nga Palët e kësaj marrëveshjeje, duke marrë në konsideratë dispozitat e ligjeve të aplikueshme të shteteve përkatëse.

## **Neni 6** **Bashkëpunimi**

1. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, marrëveshjeve dypalëshe, palët do të bashkëpunojnë mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit të ndërsjellë nëpërmjet:
  - 1.1 dhënies së ndihmës dhe sigurimit të informacionit, sipas kërkesës në rast të fatkeqësisë/Incidentit të kërkim-shpëtimit (SAR) apo rrezikut të ndodhjes së fatkeqësisë.
  - 1.2 shkëmbimit të informacionit, dokumentacionit tekniko-ligjor, literaturës metodologjike dhe llojeve të tjera.
  - 1.3 organizimit dhe mbajtjes së takimeve të përbashkëta të ekspertëve, seminareve, konferencave dhe veprimtarive ushtrimore në fushën e kërkim-shpëtimit (SAR) në nivele të ndryshme.
  - 1.4 organizimit të shkëmbimit dhe të trajnimit të ekspertëve apo njësisve SAR.
2. Palët do t'i japin njëra-tjetrës asistencë në rast fatkeqësie, brenda kapaciteteve të tyre.
3. Elementet vartëse të Palëve mund të parashikojnë një koordinim dhe bashkëpunim të mëtijshëm përmes krijimit të rregullimeve dhe procedurave të përshtatshme operacionale në përputhje me këtë Marrëveshje.
4. Përveç informacionit në lidhje me raste specifike SAR, Palët mund të shkëmbejnë çdo informacion tjetër që mund të shërbejë për të përmirësuar efektivitetin e operacioneve të SAR.
5. Palët do të përpiqen të promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e kërkim shpëtimit malor dhe ujërat territorial me fokus, ushtrime dhe trajnime të përbashkëta, vizita të ndërsjella të grupeve të punës dhe përdorimin e sistemeve të raportimit të pajisjeve për qëllime SAR.
6. Autoritetet kompetente të përmendura në këtë Marrëveshjeje garantojnë të gjitha masat e nevojshme për krijimin e komunikimit të besueshëm dhe të vazhdueshëm për nevojat e shërbimit të kërkim shpëtimit të vendeve tona si dhe komunikimin e njësisve/ekipeve të shpëtimit dhe/ose ekspertët në vendin e operacioneve në raste fatkeqësisë/ Incidentesh në fushën e kërkim- shpëtimit (SAR).

## **Neni 7** **Procedura për dhënien e ndihmës**

1. Pala që përballlet me një fatkeqësi ka të drejtë të kërkojë ndihmë nga pala tjetër ndihmuese.
2. Kërkesa për ndihmë do të bëhet me shkrim nga pala kërkuese.
3. Ndihma e ndërsjellët mund të jepet me ekipe, ekspertë, pajisje për kërkim-shpëtim dhe materiale humanitare.
3. Në çdo rast, veprimet operacionale të përbashkëta do të koordinohen nga autoriteti i Palës Kërkuese. Vetëm drejtuesit e ekipeve të Palës ndihmuese mund t'u japin udhëzime teknike ekipeve të tyre.

4. Pala Kërkuese (autoriteti përgjegjës) do të informojë drejtuesit e ekipit të ndihmës apo ekspertët rreth situatës në territorin e përfshirë nga fatkeqësia, do të përcaktojë vazhdimësinë e veprimeve dhe shërbime të kërkuara për nevojat që kanë ekipet SAR në terren.
5. Me kryerjen e detyrës së tyre ose më shpejt, nëse kjo kërkohet nga autoritet e Palëve të kësaj Marrëveshjeje, ekipet apo ekspertët e ndihmës do të largohen nga territori i Palës Kërkuese.

#### **Neni 8**

##### **Procedurat e kalimit kufitar**

1. Pala kërkuese duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar procedurat në pikën e kalimit kufitar nga ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertëve të palës ndihmuese.
2. Drejtuesi i njësisë/ekipit të shpëtimit duhet t'u paraqesë zyrtarëve kufitarë dhe zyrtarëve doganorë të palës kërkuese dokumentet e certifikuara nga autoriteti kompetent i palës ndihmuese.
3. Anëtarët e Njësive të Kërkim-Shpëtimit mund të veshin uniformat e tyre në territorin e palës kërkuese. Njësitë e Kërkimit dhe Shpëtimit të Palës ndihmuese autorizohen që të përdorin shenjat e tyre dalluese në mjetet e tyre në territorin e Palës kërkuese.
4. Procedura e kalimit kufitar, do të jetë në përputhje me marrëveshjen e statusit të forcave gjatë kalimit transit të forcave dhe mjeteve në territoret respektive të të dy vendeve.

#### **Neni 9**

##### **Financat, kujdesi i shëndetit dhe sigurimi i jetës**

1. Kompensimi i dëmeve të shkaktuara në territorin e Palës Pritëse, nga personeli i Palës ndihmuese gjatë kryerjes së detyrave të tyre, operacion, stërvitje ose në lidhje me to, do të llogaritet sipas legjislacionit në fuqi të shtetit të Palës Pritëse.
2. Çdo mosmarrëveshje që do të lind në rastet e dëmtimeve të bëra ekskluzivisht në pajisjet dhe mjediset e kryerjes së aktivitetit, do të zgjidhet në mënyrë miqësore pa iu drejtuar autoriteteve gjyqësore kombëtare ose ndërkombëtare. Në rastet kur një mosmarrëveshje e tillë nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.
3. Pala kërkuese do të ofrojë siguri dhe mjekime falas për ekipet e shpëtimit dhe/ose ekspertët e dërguar nga pala ndihmuese, si dhe mbështetje logjistike për kohën e misionit të tyre.
4. Nëse ekipet apo ekspertët e kërkim-shpëtimit, që marrin pjesë në dhënien e ndihmës i shpenzojnë rezervat e tyre, atëherë shpenzimet për sigurimin, akomodimin dhe materialet për nevojat e tyre, deri në përfundimin e misionit të tyre, do të mbulohen nga Pala Kërkuese dhe më pas të kompensohet nga Pala tjetër.
5. personeli i palës ndihmuese gjatë kohës së qëndrimit të tyre në territorin e palës kërkuese duhet të jetë i pajisur me siguracion shëndeti dhe njëkohësisht të ketë në pajisjet e tyre në medikamente të urgjencës shëndetësore.
6. Palët do të ndërveprojnë sipas legjislacionit të tyre në fuqi, për të lehtësuar zgjidhjen e çdo kërkese për dëmet dhe kompensimet. Palët në fjalë do të shkëmbejnë të gjithë informacionin në dispozicion në të gjitha rastet e dëmeve brenda kuptimit të dhënë në këtë nen.

**Neni 10**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në interpretimin apo në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve, zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

**Neni 11**  
**Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare**


Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të Palëve, që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të lidhura ndërmjet tyre dhe/ose në të cilat ato janë Palë.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga Palët.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, me anë të protokolleve shtesë. Protokollet shtesë në fjalë do të jenë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjnë në fuqi, në përputhje me procedurën e caktuar për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.
3. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila Palë mund të ndërpres efektin e saj, duke i dërguar një njoftim me shkrim brenda një afati të arsyeshëm Palës tjetër nëpërmjet pikave të kontaktit të Autoritet Kompetent. Çdo ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër.

Bërë në Prishtinë, më 20 qershor 2022, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, një për secilën palë.

**PËR MINISTRINË E MBROJTJES  
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**



**PËR MINISTRINË E MBROJTJES  
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

